



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:227099
Datë: 29.08.2024
Numri i dokumentit: 06100206

AC-I-24-0181

Në ankesën e

Paditësi

Z K, të cilin e përfaqëson Avokati B I, Prishtinë.

Kundër

E paditura/Ankuesja

NSH, "Ingeniering", (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. 'Dritan Hoxha, nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj, dhe Manushe Karaqi gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5573 të datës 14 shkurt 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 29 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5573 i datës 14 shkurt 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 19 qershor 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS-ë një ankesë kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit PRN129-0074 të datës 15 maj 2014, me të cilin kërkesa e paditësit për paga të papaguara në periudhë të pacaktuar, në shumë prej 5,553.70 euro refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi paraqet ankesë edhe ndaj Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN129-0073 të datës 08 maj 2014, me të cilin kërkesa e paditësit për pagesën e tri pagave të pa paguara në shumë prej 1,170.00 euro, po ashtu refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi i kundërshton të dy vendimet e Autoritetit të Likuidimit duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, dhe duke e kundërshtuar konstatimin se kërkesat janë parashkruar. Në këtë ankesë paditësi në emër të tri pagave të papaguara e kërkon shumën prej 1,170.00 euro duke pretenduar se ai ka punuar në NSH deri në ditën e privatizimit të NSH-së, me 14.01.2009, dhe i takojnë këto tri paga. Në ankesën e dorëzuar në Shkallën e I-rë, lidhur me pagat e kërkuara në faqen 3 të ankesës e përcakton periudhën, duke kërkuar pagat për periudhën 2007-2008, dhe kërkon shumën prej 5,553.70 euro si dhe interesin ligjor. Bashkë me ankesë ai ka dërguar: Autorizimin për përfaqësim, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me 14.01.2009, vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN129-0074 të datës 15 maj 2014 si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN129-0073 të datës 08 maj 2014, një Vërtetim për përvojë pune të NSH-së, dhe një Listë të pagave të nënshkruar nga vetë Avokati.

Me datë 21 prill 2020, paditësi e dorëzoi në DHPGJS-ë një parashtresë për rregullim dhe plotësim të padisë. Kjo parashtresë në fakt është ankesë e paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN129-0073 të datës 08 maj 2014, me të cilën ai kërkon të detyrohet e paditura që të paguhet tri paga për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Paditësi i përsërit pretendimet e paraqitura në ankesën fillestare. Në këtë parashtresë ai në emër të pagave të papaguara e kërkon shumën prej 5,257.31 euro (në ankesën fillestare dhe tek Autoriteti i Likuidimit ka kërkuar shumën prej 5,553.70 euro), ndërsa në emër të 3 pagave të pa paguara kërkon shumën prej 1,170.00 euro si dhe kërkon interesin ligjor dhe shpenzimet e përfaqësimit. Bashkë me këtë parashtresë paditësi ka dërguar një kopje të Listave

të pagave të muajit dhjetor 2006, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 14 janar 2009, Kopjen e Librezës së punës, një Vërtetim të NSH-së për pagat e mbetur borxh i datës 31.12.2008, Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN129-0074 të datës 15 maj 2014, dhe PRN129-0073 të datës 08 maj 2014, dhe Autorizimin e Avokatit.

Me datë 10 gusht 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë në të cilën AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar në mënyrë të drejtë kur është refuzuar kërkesa e paditësit. Tutje AKP-ja pohon se ankuesi ka dështuar tregojë se cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit, duke pohuar se vendimi i ankimuar nuk është në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore. Tutje AKP-ja pretendon se paditësi nuk ka dorëzuar ndonjë provë para Autoritetit të Likuidimit për të dëshmuar se ai ka kërkuar pagat e pretenduara në afatin prej 3 viteve, andaj kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja i kundërshton pretendimet e paditësit edhe për tri pagat e pretenduara ndaj NSH-së, duke pohuar se ai nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së ti njihet e drejta në tri paga, pasi që nuk dorëzuar prova që vërtetojnë detyrimin e NSH-së për këtë kërkesë. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohen vendimet e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 14 shkurt 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-5573 ankesën e paditësit të paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN129-0074 të datës 15 maj 2014, e aprovon si të bazuar, e ndryshon këtë vendim të Autoritetit të Likuidimit dhe e detyron AKP-në që në emër të pagave të papaguara ti paguaj paditësit shumën prej 5,553.70 euro, interesin ligjor prej 10%, në shumë prej 555.37 euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore prej 134.00 euro, të cilat pagesa do të bëhen në bazë të nenit 40 par.1 nënpika 1.7 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se nga shkresat e lëndës, gjykata gjen që ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRN0129-0074, të datës 15 maj 2014, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për paga të papaguara për periudhë të pacaktuar kohore në shumë prej 5,553.70 € dhe kamatë nga NSH "Ingeniering" (në likuidim). Vendimi PRN129-0073, që i referohet kërkesës për prioritet të pagesës së tre pagave të fundit, i dorëzuar nga përfaqësuesi i

ankuesit me parashtresën e datës 21 prill 2020, nuk është objekt i shqyrtimit të kësaj ankese. Për më tepër një kërkesë e tillë në kuptim të nenit 40.1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tre (3) pagave të fundit të papaguara. Neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: *"Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës"*. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: *"I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit"*. Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH "Ingeniering". Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja se a ka ofruar shërbime pune ankuesi dhe a i ka mbetur NSH borxh pagat për periudhën 2007 – 2008. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se kërkesa e tij për kompensimin e pagave të papaguara është parashkruar, ndërsa ankuesi pretendon se ka qenë në listën e pagave deri në privatizimin e NSH. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij ndër të tjera e mbështet në: Vërtetimin mbi borxhin e mbetur për periudhën 2007-2008 datë 31 dhjetor 2008, Vërtetimin mbi përvojën e punës, Librezën e tij të punës, Njoftimin për përfundimin e punësimit, lëshuar me 14 janar 2009 nga AKP, Llogaritja e të ardhurave personale për muajin dhjetor 2006 të lëshuar nga NSH dhe si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë. Nga, Libreza e tij e punës, Vërtetimi mbi përvojën e punës dhe njoftimi për përfundimin e punësimit, i datës 14 janar 2009, të dorëzuara si prova, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH "Ingeniering" në periudhën kohore prej 2 tetor 1986 deri me 14 janar 2009, kohë edhe kur shumica e aseteve të NSH-së janë shitur apo NSH është privatizuar dhe si pasojë marrëdhënia e punës së ankuesit ka pushuar. Nga Vërtetimi mbi borxhin e mbetur për periudhën 2007 – 2008 datë 31 dhjetor 2008, (e cila nuk kontestohet nga e paditura) vërtetohet fakti se ankuesi kishte punuar në NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh ankuesit disa paga për periudhën 2007 – 2008 dhe atë të gjitha këto në shumë totale prej 6,120.48 €. Gjykata gjen se ekziston një diferencë në shumën e kërkuar nga ankuesi në raport me shumën e cekur në vërtetimin në fjalë përkatësisht shuma në këtë vërtetim është më e lartë se sa shuma e kërkuar në procedurë të likuidimit tek AL, andaj çdo shumë përtej shumës së kërkesës së shqyrtuar tek AL për periudhën objekt kontesti, nuk do të shqyrtohet këtu dhe rrjedhimisht shuma prej 5,553.70 € përfshirë kamatën është

kërkesa objekt kontesti në këtë rast. Nisur nga kjo gjendje, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, Libreza e tij e punës, Vërtetimi mbi përvojën e punës, Njoftimin për përfundimin e punësimit, datë 14 janar 2009 dhe Vërtetimin mbi borxhin e mbetur për periudhën 2007 – 2008 datë 31 dhjetor 2008, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se NSH nuk i ka mbetur borxh pagat, ashtu siç ka pretenduar ankuesi. Meqenëse e paditura nuk e ka kontestuar periudhën kohore të pagave të papaguara dhe as lartësinë apo shumën totale të pagave të papaguara të kërkuara nga ankuesi, si dhe nuk ka ofruar asnjë provë që do mund të rrëzonin pretendimet e ankuesit, gjykata e aprovon kërkesën e tij. Gjukata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Ankuesi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë AL me 04 tetor 2013. Gjukata vlerëson se, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 14 janar 2009 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore. Andaj, gjykata vie në përfundim se ankuesi kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit në lidhje me këtë NSH (AC-I-20-0508, AC-I-22-0123, AC-I-22-0228). Gjukata e aprovon shumën në lartësi prej 555.37 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Me datë 07 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5573 të datës 14 shkurt 2024, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit

të Likuidimit, dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja pohon se me Aktvendimin e ankimuar nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale dhe nuk janë marrë në konsideratë argumentet ligjore të dhëna në vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe në mbrojtjen në ankesë. Tutje AKP-ja pohon se gjetjet faktike të gjykatës janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes dhe plotësisht të pa bazuara në ndonjë dokument që ekzistojnë në dosje të lëndës. Tutje AKP-ja pohon se Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme, njëra që ndërlidhet me afatin për parashtrimin e kërkesave i cili afat i përket procedurës së dorëzimit të dëshmisë së kërkesës dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat e të drejtës e që ka të bëjë me afatin e parashkrimit të kërkesës e që në këtë rast është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të punës së Bashkuar. Tutje AKP-ja pohon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dërguar tek paditësi ka pas për qëllim të informon atë se ai ka të drejtë të parashtrij kërkesë pranë AKP-së dhe se ky njoftim nuk i mbron të drejtat e tij dhe nuk siguron mjete ligjore që ai ka në dispozicion. AKP-ja pohon se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes nuk ka marr parasysh faktin se paditësi nuk ka qenë në Listën e pagave për periudhën e cekur. Tutje AKP-ja në ankesë pohon se paditësi nuk ka saktësuar cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur, duke pohuar se DHPGJS-ja ka kompetencë të shqyrtoi vetëm ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se gjykata duhet të lëshohet në shqyrtimin e çështjes dhe të marrë në konsideratë argumentet e ngritura të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 08 maj 2024, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi pretendon se Aktvendimi i ankimuar është marrë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe në mbështetje të dispozitave materiale. Tutje paditësi pohon se e paditura i ka dhënë të njëjtat argumente të cilat janë prezantuar edhe në procedurën me shkrim pranë Shkallës së I-rë, ndërsa nuk ka paraqitur një provë të re ose ndonjë argument ligjor në procedurën ankimore. Këto pretendime janë të pa bazuara pasi që paditësi ka dorëzuar dëshmi të mjaftuara se ai ka punuar deri në privatizimin e ndërmarrjes me datë 15 maj 2008. Në këtë parashtresë paditësi i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit. Paditësi në këtë

parashtresë ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa si epa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë të DHPGJS është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 04 tetor 2013 kishte dorëzuar një kërkesë për kompensim të tri pagave të papaguara në shumë prej 1,170.00 euro, si dhe një kërkesë për kompensim të pagave të pa paguara për periudhë të pa përcaktuar shume prej 5,553.70 euro. Të dy kërkesat janë refuzuar si të pa vlefshme nga ana e Autoritetit të Likuidimit me arsyetimin se ato janë parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së bashkuar.

Ndaj këtyre vendimeve të Autoritetit të Likuidimit paditësi me datë 19 qershor 2014 ka paraqitur ankesë. Paditësi i kundërshton të dy vendimet e Autoritetit të Likuidimit duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, dhe duke e kundërshtuar konstatimin se kërkesat janë parashkruar. Në këtë ankesë paditësi në emër të tri pagave të papaguara e kërkon shumën prej 1,170.00 euro, duke pretenduar se ai ka punuar në NSH deri në ditën e privatizimit të NSH-së, me 14.01.2009, dhe i takojnë këto tri paga. Në ankesën e dorëzuar në Shkallën e I-rë, lidhur me pagat e kërkuara në faqen 3 të ankesës e përcakton periudhën, duke kërkuar pagat për periudhën 2007-2008, në shumë prej 5,553.70 euro, aq sa kishte kërkuar tek Autoriteti i Likuidimit.

Tutje paditësi me datë 21 prill 2020, e dorëzoi në DHPGJS-ë një parashtresë për rregullim dhe plotësim të padisë. Në këtë parashtresë ai në emër të pagave të papaguara ka kërkuar shumën prej 5,553.70 euro, ndërsa për tri paga të papaguara

ka kërkuar shumën prej 1,170.00 euro. E paditura në parashtrirat e saj gjatë procedurës me shkrim e konteston kërkesën vetëm për shkak të parashkrimit, ndërsa nuk e konteston lartësinë e kërkuar të kompensimit në emër të pagave të papaguara për periudhën e cekur.

Duke qenë se tek Autoriteti i Likuidimit paditësi në emër të pagave të pa paguara ka kërkuar shumën prej 5,553.70 euro, dhe të njëjtën shumë e kërkon edhe me ankesën e datës 19 qershor 2014, Kolegji i Apelit gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë do të konsideroj se kjo është shuma e kërkuar nga paditësi në emër të pagave të papaguara për periudhën 2007-2008.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën në shkallën e parë, ka dërguar një kopje të Listave të pagave të muajit dhjetor 2006, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 14 janar 2009, Kopjen e Librezës së punës, një Vërtetim të NSH-së për pagat e mbetur borxh i datës 31.12.2008, Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN129-0074 të datës 15 maj 2014, dhe PRN129-0073 të datës 08 maj 2014, dhe Autorizimin e Avokatit.

Duke u bazuar në këto prova dhe në faktin se AKP-ja me mbrojtje në ankesë nuk e ka kontestuar shumën e kërkuar në emër të pagave të papaguara, shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e ka aprovuar ankesën e paditësit lidhur me kërkesën për paga dhe e ka ndryshuar Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN129-0074 të datës 15 maj 2014, pasi që ky vendim nuk kishte mbështetje në ligj.

Kolegji i Apelit nuk e mbështet konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për paga të pa paguara vitet 2007 - 2008 është parashkruar, pasi që ky konstatim nuk mbështetet në provat të cilat paditësi i ka dorëzuar tek Gjykata e Shkallës së I-rë.

Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 14.01.2009, siç ka konstatuar në shumë raste Kolegji i Apelit në jurisprudencën e tij, e ndërprente afatin e parashkrimit të kërkesës, pasi që e paditura e ka pranuar ekzistimin e borxhit.

Tutje paditësi ka sjellë njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kopjen e Librezës së punës të mbyllur me 14 janar 2009, si dhe Listat e pagave për vitin 2007 dhe 2008. Në këtë njoftim konstatohet se ndërprerja e punësimit përfundon menjëherë dhe se shumat-pagat që janë mbetur borxh sipas kontratës së punësimit, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit, ndërsa kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se shkalla e I-rë e DHPGJS-së ankesën e paditësit e paraqitur kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN129-0073 të datës 08 maj 2014, e parashtruar me parashtresën për rregullim të padisë me datë 21 prill 2020, në dispozitiv fare për këtë vendim nuk ka vendosur, ndërsa në pjesën e arsytimit ligjor konstaton se ky vendim nuk ishte objekt i ankesës.

Ndaj këtij vendimi nuk ka ankesë nga paditësi, andaj Kolegji i Apelit nuk merr qëndrim ligjor për saktësinë dhe ligjshmërinë e këtij vendimi të shkallës së I-rë të DHPGJS-së.

Nga këto arsye ankesa e paditurës refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro, me datë 26 mars 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 29 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____